



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

RAPORTI VJETOR I NJËSISË PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE PËR VITIN 2022 - KOMUNA E PODUJEVËS

Data:	10.01.2023
Nr.	13-401/04-0002464/23
Drejtorja/Sektori/Zyra	Njësia e Burimeve Njerëzore
Periudha Raportuese	Janar - Dhjetor 2022
Raportuesi	Fitim Bunjaku - Menaxher i Burimeve Njerëzore
Kryetari i Komunës	Shpejtim Bulliqi



1. PËRMBLEDHJE

Gjatë Vitit 2022 Njësia e Burimeve Njerëzore krahas sfidave ka arritur edhe në realizimin e shumë aktiviteteve lidhur me fushën e burime njerëzore si: planifikimin, organizmin e rekrutimeve, pushimet online të nëpunësve, përcjelljen çdo muaj të ndryshimeve lidhur me pagat dhe mëditjet e nëpunësve në MF, pranimin dhe përcjelljen e listave të pagave përmes Sistemit të Pagave (PMS), përcjelljen e procedurave të largimit të stafit sipas legjislacionit në fuqi, pranimin e një numri të konsiderueshëm të kërkesave lidhur me dokumentet dhe të dhënat që posedon Njësia e Burimeve Njerëzore sa i përket stafit aktual dhe ish stafit, lëshimin e vërtetimeve mbi përvojën e punës, punës praktike, pushimeve dhe për çdo çështje tjetër lidhur me fushën e saj,

ofrimin e fakteve të kërkuara nga KPMSHCK lidhur me ankesat e palëve, ofrimin e fakteve Komisionit Disiplinor dhe atij të Ankesave si dhe përcjelljen e procedurave të inicuar, mirëmbajtjen e dosjeve të Personelit, përditësimin e bazës së të dhënave lidhur me nëpunësit, deklarimin e statusit të Zyrtarëve Publik, ofrimin e qasjeve dhe asistim të nëpunësve, komisioneve, aplikantëve në HRMIS/SIMBNJ, përcjelljen e SVP-së etj.

Stafi i kësaj njësie përkundër faktit që realisht është i pamjaftueshëm, krahas aspektit të gjerë të punëve, i është përgjigjur të gjitha kërkesave në kompetencën e tij dhe ka qenë bashkëpunues me komisionet, stafin tjetër të institucionit, palët e jashtme dhe institucionet e tjera.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

-Përpilimi i Draft Planit dhe Planit të Personelit për Vitin 2023 për Zyrtarët Publik në SIMBNJ/HRMIS;

-Përgatitja e të dhënave për DMZP-në lidhur me titujt e vendeve të punës, klasën e propozuar, grupin e propozuar, kodin sipas Katalogut të nëpunësve civil si dhe Skenimin e të gjitha Aktemërimeve/Kontratave të punës për Zyrtarët Publik të Komunës së Podujevës.

-Raporti i Statistikave për vitin paraprak në SIMBNJ;

-Deklarimi i statusit të Zyrtarëve Publik;

-Përgatitja e të dhënave të kërkuara lidhur me kompensimin material të nëpunësve civil lidhur me ankesën në KPMSHCK;

-Inicimin e Procedurave për Rekrutimet Lëvizje Brenda Kategorisë;

-Inicimin e Procedurave për Rekrutimet Ngritje në Detyrë (Avancim);

-Inicimin e Procedurave për Rekrutimet Pranim;

-Zhvillimin e Procedurave të Rekrutimit për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

-Zhvillimin e Procedurave të Rekrutimit për Drejtorinë e Arsimit;

-Pranimi i Listës së pagave për çdo muaj;

-Përpunimi mujor i ndryshimeve për listën e pagave (pagesat shtesë për nëpunësit, largime të nëpunësve, hyrje të reja, transfere bankare, pezullime, pushime të lehonisë, pushime pa pagesë etj.);

-Implementimin e Pushimeve në SIMBNJ (Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore);

-Mbajtja e Trajnimeve nga IKAP;

-Implementimin e aplikacionit HRMIS;

-Implementimin e Portalit për Publikime të Konkurseve për Zyrtarët Publikë;

-Asistimin për aplikim online tek aplikantët;

-Përditësimi i të dhënave të nëpunësve në SIMBNJ;

- Mbajtja dhe përditësimi i listës dhe informimi i Zyrtarëve të Lartë Publik lidhur me Deklarimin e Pasurisë në Agjencionin Kundër Korrupsionit;

-Aktivitetet rutinore të Zyrës (Pranimi, shpërndarja për nënshkrime e listës mujore të pagave, mbajtja e evidencës së pushimeve në forme fizike dhe elektronike, përgatitja e vertetimave sipas kërkesës, nxjerrja e vendimeve në kompetencën e saj etj.)

3. STATISTIKAT

-Komuna e Podujevës ka të autorizuar gjithsej **284** nëpunës në Administratën Komunale. Në fund të Vitit 2022 duke e përfshirë dhe stafin politik ishin total 266 nëpunës prej të cilëve 18 Staf Politik dhe Nëpunës Kabineti, 183 Nëpunës Civilë, 12 Shërbyes Publikë dhe 53 Staf mbështetës dhe administrativ. Nga total 266 nëpunës 263 janë shqipëtarë, 2 Ashkali dhe 1 serb, 93 prej tyre janë femra dhe 173 meshkuj.

Sa i përket kualifikimit, 38 nëpunës kanë kualifikim Superior, 132 nëpunës kanë kualifikim të lartë (Shkolle e Lartë, Fakultet), 91 Shkollim të Mesëm dhe 5 Shkollim Fillor.

-Vende të planifikuara të lira për Vitin 2022 në Administratën Komunale kanë qenë 29 si dhe 7 vende të lira të cilat janë krijuar nga pensionet e rregullta të nëpunësve.

-Përgjatë Vitit 2022 janë larguar **16** nëpunës, prej të cilëve shtatë (7) me Pensionim të Rregullt, 8 dorëheqe, 1 shkarkim.

-Në Vitin 2022 janë shpallur 68 procedura të rekrutimit Shërbyes Civil dhe janë rekrutuar 27 pozita prej të cilave **22** pozita me Pranim, 3 Lëvizje Brenda Kategorisë, Avancim 2.

-Në Vitin 2022 janë rekrutuar **5** pozita staf mbështetës dhe **1** pozitë Shërbyes publik.

-Me kërkesën e institucioneve përkatëse dhe aprovimi nga ZKA-s janë bërë 15 Transfere të nëpunësve prej të cilave 14 të brendshme dhe një (1) i jashtëm.

4.SFIDAT

Hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrarët Publikë ka penguar zhvillimin e procedurave duke pasë plotësim/ndryshime të Akteve nënligjore.

Mungesa e kompetencave për ndërhyrje në HRMIS dhe ndryshimi i tij varësisht prej legjislacionit, ka paraqitur shpesh pengesa dhe vonesa në zhvillimin e procedurave të cilat duhet kryer përmes tij (psh. pushimet online, probleme në krijimin e qasjeve për nëpunësit).

Mungesa e një udhëzuesi praktik lidhur me përdorimin e Sistemit online për aplikim dhe po ashtu mungesa e trajnimeve lidhur me këtë sistem ka paraqitur paqartësi lidhur me aplikimin e kandidatëve.

5.REKOMANDIME

Njësia e Burimeve Njerëzore rekomandon që të gjitha kërkesat e drejtuara drejt saj të bëhen në mbështetje të ligjeve/rregulloreve të reja në fuqi dhe brenda afateve kohore.

Mbajtja e trajnimeve të vazhdueshme për stafin e Njesisë së Burimeve Njerëzore nga institucionet kompetente lidhur me plotësim ndryshimet e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe akteve nënligjore të cilat kanë pësuar ndryshime.

Të krijohen kushtet teknike për implementimin e Ligjit për Zyrtarët Publik në aspektin e rekrutimit bazuar në rekomandimet e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe akteve nënligjore.

Shtojcë

Bashkëngjitur janë Statistikat e nëpunësve civilë, shërbyesve publik dhe nëpunësve administrativ dhe mbështetës për Vitin 2022 në formë tabelare.

Numri i Zyrtarëve Publik - 2022

Kategoria funksionale	Numri i zyrtarëve publik në fillim të vitit 2022	Vendet e lira pune dhe të planifikuara për rekrutim në fillim të vitit 2022	Numri i nëpunësve civil të larguar nga Zyrtarët Publik në vitin 2022	Vendet e plotësuara gjatë vitit 2022	Numri i zyrtarëve publik në fund të vitit 2022
Gjithsej	254	36	16	28	266

Kualifikimi

Kategoria funksionale	Shkollim Fillor	Shkollim i Mesëm	Shkollim i Lartë (Fakultet)	Shkollim Superior (Master, PHD)	
Niveli i Lartë Drejtues					
Niveli Drejtues		1	13	6	
Niveli Profesional		46	105	27	
Niveli Tekniko-Administrativ	5	41	3	1	
Gjithsej	5	88	121	34	248

Gjinia

Niveli i Institucionit	Meshkuj	Femra	Totali
Niveli Komunal	173	93	266

Nacionaliteti				
Komunitetet	Niveli Qendror	Niveli Komunal	Nivel lokal dhe qendror së bashku	Në përqindje
Shqiptarë		263		
Serbë		1		
Boshnjakë				
Turq				
Goranë				
Romë				
Ashkalinjë		2		
Egjiptianë				
Të tjerë				

Transferimet				
Kategoritë funksionale	Transferim brenda institucionit përkatës	Transferim në institucion tjetër te SHCK-së	Totali	Në përqindje
Niveli i lartë udhëheqës				
Niveli udhëheqës	1			
Niveli profesional	13	1		
Niveli administrativ				
Gjithsej	14	1		

Rekrutimet		
Kategoritë funksionale	Rekrutimet e jashtme	Rekrutimet e brendshme
Niveli i lartë udhëheqës		
Niveli udhëheqës	1	2
Niveli profesional	22	3
Niveli administrativ	5	
Gjithsej	28	5

Largimet							
Kategoritë funksionale	Me dëshirë	Masë disiplinore	Shkurtim i pozitës	Pensionim i parakohshëm	Pensioni m i rregullt	Shkak tjetër	Totali
Niveli i Lartë Drejtues							
Niveli Drejtues					1	1	
Niveli Profesional	7			3	6		
Niveli Teknik-Administrativ	1						
Gjithsej	8			3	7	1	19